

ANALIZË E SHPENZIMEVE DHE HAPËSIRËS FISKALE

PËRFSHIRË BUXHETIMIN E NDJESHËM GJINOR
DHE PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI





ANALIZË E SHPENZIMEVE DHE HAPËSIRËS FISKALE

PËRFSHIRË BUXHETIMIN E NDJESHËM GJINOR
DHE PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

UN Women është organizata e Kombeve të Bashkuara e përkushtuar për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Si organizatë kampione për gratë dhe vajzat, UN Women u themelua me qëllim përsheptimin e ecurisë për përmbushjen e nevojave të tyre në mbarë botën.



UN Women zyra e Shqipërisë,
Rr. "Skenderbej", Ndërtesa 8, Ap. 29-31, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 450 2555/7575
E-mail: unwomen.albania@unwomen.org
Website: <https://albania.unwomen.org>

Ky botim është hartuar në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Mbështetje për financimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm", i financuar nga Fondi i Përbashkët i Kombeve të bashkuara për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Kombeve të Bashkuara ose cilëndo prej organizatave të lidhura me to.

Për të shkarkuar këtë botim, ju lutemi shkoni në faqen: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications>

Autori: Shakespeare Vaidya
Përpunimi grafik: HL Branding
Të gjitha të drejtat e rezervuara
© UN Women 2022

Tabela e përmbajtjes

SHKURTESA DHE SHKURTIME	6
I HYRJE.....	7
I.1 Metodologjia.....	7
2 CËNUESHMËRITË SOCIO-EKONOMIKE ME NDJESHMËRI GJINORE DHE PËR FËMIJËN NË SHQIPËRI	8
2.1 Varfëria.....	8
2.2 Potenciali i të ardhurave.....	10
2.3 COVID-19 dhe Ndikimi i tij Socio-Ekonomik mbi Grupet e Cënueshme	12
2.4 Dimensioi Gjnor i Informalitetit, Punës së Padeklaruar, Punës së Papaguar të Kujdesit.....	13
3 PANORAMË E DIMENSIONEVE GJINORE TË MBROJTJES SOCIALE NË SHQIPËRI	16
3.1 Fuqia Negociuese dhe Puna e Papaguar e Kujdesit	16
4 PANORAMË E SISTEMIT FISKAL PËR MBROJTJEN SOCIALE NË SHQIPËRI	19
4.1 Panoramë e Përpjekjeve të Buxhetimit me Ndjeshmëri Gjnore.....	19
4.2 Analiza e Disponueshmërisë së Burimeve për Mbrojtjen Sociale në Shqipëri	21
4.3 Shpenzimet për Mbrojtjes Sociale dhe Përshtatshmëria e Përfitimeve	23
4.4 Hapësira Fiskale për Mbrojtjen Sociale.....	26
5 PËRFUNDIME	27

Shkurtesa dhe shkurtime

BE	Bashkimi Evropian
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
ABF	Anketa e Buxhetit të Familjes
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
ODA	Asistenca Zyrtare për Zhvillim
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar

I. Hyrje

Pjesëmarrja më e madhe e femrave në fuqinë punëtore nxit rritjen ekonomike në mënyrë të drejtpërdrejtë. Fuqizimi ekonomik i grave është kyç për rritjen, si përmes ndikimit të drejtpërdrejtë në përmasat e fuqisë punëtore dhe përmes ndikimit në prodhimtari (Cuberes dhe Teignier 2016), ashtu edhe përmes kërkesës më të madhe vendase. Për më tepër, Organizata Ndërkombëtare e Punës vlerëson se ngushtimi i hendekut gjinor në pjesëmarrjen në tregun e punës me 25% do të rriste PBB-në botërore me 3,9% (ILO 2017). Politikat fiskale janë një instrument i fuqishëm për ngushtimin e hendeqeve gjinore. Në ekonomitë e përparuara, *subvencionet për kujdesin për fëmijën, leja prindërore me pagesë, dhe kalimi nga deklaratimet tatimore familjare në ato individuale janë përdorur për të nxitur pjesëmarrjen e femrave në tregun e punës* (Andresen dhe Havnes 2019; Bick dhe Fuchs-Schündeln 2017; Gelbach 2002; Kalb 2018; Christiansen dhe të tjerë 2016b, c). Në ekonomitë në zhvillim, investimi në arsimin e femrave dhe në infrastrukturë (përfshirë energjinë elektrike, rrugët, ujësjellës dhe kanalizime) që pakësojnë kohën që u duhet grave për veprimtaritë në familje, ka sjellë rezultate pozitive sa i përket pjesëmarrjes së femrave në fuqinë punëtore (Cubas 2016; Dinkelmann 2011; Ilahi dhe Grimard 2000; Jain Chandra dhe të tjerë 2018). Transferta në para kanë pasur gjithashtu efekt pozitiv mbi pjesëmarrjen e femrave në fuqinë punëtore¹.

I.1 Metodologjia

Analiza e vendit për shpenzimet dhe hapësirën fiskale, përfshirë buxhetimin me ndjeshmëri gjinore dhe për fëmijën (shpenzimet publike) në Shqipëri, është një studim cilësor i kryer duke përdorur të dhënat e anketimeve të fuqisë punëtore, raportet e botuara dhe raportin e vlerësimit të COVID-19, raporte të tjera të anketimeve të barasvlershme, informacione administrative, dhe të dhënat e anketimit të familjeve, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë e INSTAT.

Qëllimi

Objekti i kësaj konsulence është të bëjë një analizë të vendit lidhur me shpenzimet dhe hapësirën fiskale, përfshirë buxhetimin me ndjeshmëri gjinore dhe për fëmijën në Shqipëri, me qëllim sigurimin e informacionit për reformat e politikave fiskale dhe hartimin e sistemeve dhe programeve të integruara për sistemin mbrojtjes sociale me ndjeshmëri gjinore dhe për fëmijën, veçanërisht në ekonominë e kujdesit. Studimi ka dy dimensione kyçe: një analizë të cenueshmërisë me ndjeshmëri gjinore nga pikëpamja e kujdesit të papaguar dhe zhvillimit të fëmijës, dhe bazuar në gjetjet përkatëse, kalimi drejt mundësimin të një reforme të politikave fiskale për trajtimin e humbjeve ekonomike që vijnë si pasojë e punës së papaguar të kujdesit, duke marrë në konsideratë edhe zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve.

Për këtë arsye, kjo analizë synon të hedhë dritë mbi objektin e politikave fiskale me përgjigjshmëri gjinore me qëllim trajtimin e cenueshmërive socio-ekonomike me ndjeshmëri gjinore dhe për fëmijën. Ky raport analizon politikën e përzgjedhura fiskale me ndjeshmëri gjinore dhe mekanizmat përmes të cilave këto politika ndikojnë sistemet e mbrojtjes sociale, përfshirë pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore, hendeqet e pagave, rritjen e PBB-së, bilancet fiskale publike, shpërndarjen e të ardhurave dhe varfërinë. Kjo siguron informacion thelbësor për politikëbërësit që synojnë të miratojnë masa të politikave fiskale me ndjeshmëri gjinore, me qëllim fuqizimin ekonomik të grave, ndërkohë që trajtojnë prioritetet e tjera ekonomike dhe sociale.

Analiza e të dhënave

Raporti mbulon një gamë të gjerë temash dhe ofron informacion gjithëpërfshirës për gjendjen socio-ekonomike lidhur me shpenzimet publike në Shqipëri. Kjo analizë krijon një profil të situatës së varfërisë dhe cenueshmërisë me në qendër gjininë në Shqipëri, bazuar në kujdesin e papaguar të ofruar nga gratë, dhe krijon një profil të situatës së varfërisë dhe cenueshmërisë me në qendër gjininë. Analiza diskuton dimensionet e mirëqenies që kanë të bëjnë me të ardhurat dhe ato që nuk kanë të bëjnë me të ardhurat në Shqipëri. Megjithatë fokusi është të kuptohet situata e segmenteve me më pak mirëqenie në popullsi (bazuar në gjini dhe fëmijët), analiza siguron informacion me vlerë për nivelin e përgjithshëm të pasurisë dhe mirëqenies për të gjithë Shqipërinë. Analiza paraqet shifrat e varfërisë dhe pabarazisë në nivel kombëtar, për shkak të punës së papaguar të kujdesit.

2. Cenueshmëritë socio-ekonomike me ndjeshmëri gjinore dhe për fëmijën në Shqipëri

Shqipëria është vend me të ardhura të mesme të larta. Ekonomia e Shqipërisë është rritur mesatarisht me 2,4% gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Sektori i shërbimeve, veçanërisht turizmi, mbizotëron në ekonomi, ndjekur nga bujqësia, industria dhe sektori i ndërtimit. Sipas Raportit të Zhvillimit Njerëzor 2019, Shqipëria renditet në vend të 69 nga 189 vende dhe territore, me Indeks Zhvillimi Njerëzor (HDI) prej 0,791. Pavarësisht progresit të arritur, Shqipëria mbetet një nga vendet më të varfra në Evropë me një normë të riskut për varfëri prej 23,4% në vitin 2018 (mesatarja e 28 vendeve të BE-së është 16,9%). Paga minimale në shkallë vendi është 232 USD, ndërsa ajo mesatare është 470 USD (sa 31 e mesatares së BE-së).

Cenueshmëria, pabarazia dhe shërbimet shoqërore

Në Shqipëri, thuhet se 40% e familjeve kanë privime materiale dhe 23,4% e popullsisë rrezikon të bjerë në varfëri². Shumë rajone dhe grupe, si komunitetet Rome dhe Egjiptiane, kanë akses të kufizuar në infrastrukturë. Përgjegjësitë familjare dhe mungesa e aksesit në kujdes për fëmijën pengojnë pjesëmarrjen e barabartë të grave në tregun formal të punës. Megjithatë kohët e fundit janë zbatuar shumë reforma premtuese në mbrojtjen sociale, përfitimet e ndihmës ekonomike janë shumë modeste dhe nuk janë të integruara me shërbimet e kujdesit.

Indeksi i Barazisë Gjinore në Republikën e Shqipërisë shënon 60,4 pikë dhe është shtatë pikë më ulët se sa mesatarja e 28 vendeve të BE-së. Indekset e Barazisë Gjinore të Shqipërisë tregojnë se 51,1% e grave janë të përfshira në kujdesin për fëmijën ose nipërit, të moshuarit, ose personat me aftësi të kufizuara çdo ditë, krahasuar kjo me 24,6% të burrave.³ Megjithatë, Indeksi i Barazisë Gjinore tregon se një pabarazi e rëndësishme strukturore lidhet me segregimin gjinor si në fushën e dijes, ashtu edhe atë të punës.

2.1 Varfëria

Shqipëria nuk ka përcaktuar një kufi zyrtar të varfërisë, kështu që matja e varfërisë nuk ka qenë e njëtrajtshme me kalimin e kohës, për shkak edhe të ndryshimit të kohëve të fundit në përkufizimin e varfërisë. Tabela I përmbledh situatën e varfërisë në Shqipëri bazuar në Anketën e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës të viteve 2017, 2018 dhe 2019. Ajo tregon përqindjen e personave që jetojnë në familje ku të ardhurat e disponueshme të barasvlershme janë nën kufirin e rrezikut për të rënë në varfëri. Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër përkufizohet si 60% e të mesmes së të ardhurave të disponueshme të barasvlershme dhe të korrigjuara sipas shkallës së barasvlershme të strukturës familjare⁴.

2. OECD 2019.

3. Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020.

4. Shkalla e barasvlershme i cakton koeficient 1,0 personit të parë në moshë madhore, 0,5 të tjerëve në moshë madhore, dhe 0,3 çdo fëmijë që jeton në familje. Për shembull, shkalla e barasvlershme e një familje me 2 të rritur dhe dy fëmijë është $1 + 0,5 + 0,3 \cdot 2 = 2,1$.

Tabela 1: Treguesit e varfërisë nga Anketa e Kushteve të Jetesës 2017-2018

Viti	2017	2018
Norma e rrezikut për të qenë i varfër; popullsia nën 60% të të mesme së të ardhurave të disponueshme të barasvlershme	23.7%	23.4%
Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër për muaj; familje me një person (Lek)	12,085	13,395
Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër për muaj; familje me një person (USD)	101.47	123.96
Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër për muaj; familje me 2 të rritur dhe 2 fëmijë në varësi (Lek)	25,378	28,130
Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër për muaj; familje me 2 të rritur dhe 2 fëmijë në varësi (USD)	213.08	260.31
Përqindja e popullsisë në rrezik për të qenë të varfër ose përjashtimi social	51.8%	49.0%
Koeficienti Gini	0.368	0.354
Raporti \$80/\$20	7.5	7.0

Burimi: Instituti i Statistikave i Shqipërisë

Në vitin 2018, 23,4% e individëve ishin në rrezik për të qenë të varfër (shkalla relative e varfërisë), krahasuar me 23,7% për vitin 2017. Tabela 5 paraqet shkallën e varfërisë sipas gjinisë. Shkalla e rrezikut për të qenë e varfër për gratë është disi më e lartë se ajo për burrat. Dallimi është zgjeruar nga 0,4 pikë përqindje në vitin 2017 në 0,8 pikë përqindje në vitin 2018. Sa i përket moshës, grupmosha 0 deri 17 vjeç është në rrezik të lartë për të qenë e varfër. Për vajzat kjo shifër tejkalon 30% në vitin 2017 dhe në vitin 2018. Tabela 2 tregon se rreziku për të qenë e varfër për femrat në vitin 2018 ishte 23,8% dhe mbetet në nivel të pandryshuar, në po 23,8% në vitin 2019.

Tabela 2: Shkalla e rrezikut për të qenë i varfër sipas gjinisë

Grupmosha	2017			2018			2019		
	Mash.	Femër	Gjithsej	Mash.	Femër	Gjithsej	Mash.	Femër	Gjithsej
0-17 vjeç	27.7	31.8	29.6	28.7	30.6	29.6	27.9	31.7	29.7
18-64 vjeç	24.0	23.4	23.7	23.2	23.3	23.2	22.3	23.3	22.8
Mbi 65 vjeç	13.0	13.7	13.4	12.5	15.4	14.0	12.9	14.8	13.9
Gjithsej	23.5	23.9	23.7	23.0	23.8	23.4	22.2	23.8	23.0

Burimi: Instituti i Statistikave i Shqipërisë

Në vitin 2019, INSTAT raportoi mbi varfërinë monetare të fëmijëve, duke përdorur treguesin e Fëmijës në Rrezik për të Qenë i Varfër të BE-së, duke botuar të dhëna për vitin 2017 dhe 2018. Sipas tyre, raportohej se rreth 29,6% e fëmijëve shqiptarë ishin në rrezik për të qenë të varfër, dhe se vajzat ndikoheshin më shumë se djemtë (30,6% dhe 28,7% përkatësisht)⁵.

Tabela 3 paraqet varfërinë dhe përjashtimin social⁶ në vend. Të dhënat për të ardhurat dhe kushtet e jetesës vërtetojnë varfërinë dhe pabarazitë shoqërore. Megjithatë përmasat e segmentit të rrezikuar për të qenë të varfër u reduktuan nga 51,8% në vitin 2017 në 46,2% në vitin 2019, segmenti i personave me privime të rënda materiale mbetet thuajse i pandryshuar në vitin 2019 në një nivel prej 23%.

5. INSTAT, 2019. Rezultatet Kyçe të EU-SILC 2017, 2018, <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-aanj/publikimet/2019/anketa-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-2017-2018/>

6. Sipas INSTAT, Rreziku për të Qenë i Varfër dhe Përjashtimi Social (sipas përkufizimit në "të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës në Shqipëri, 2019) i referohet individëve që janë në rrezik për të qenë të varfër ose të privuar rëndë në aspektin material, apo që jetojnë në një familje me intensitet shumë të ulët në punësim.

Tabela 3: Varfëria dhe përjashtimi social

Treguesit	2017	2018	2019
Privimi i rëndë material (%) (mungesa e 4 nga 9 kategorive të privimit material)	23,7	23,4	23,0
Intensiteti shumë i ulët i punës (%)	41,1	38,3	37,1
Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE) (%)	14,4	13,3	12,4
Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër; familje me një person (Lek)	51,8	49,0	46,2
Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër; familje me 2 të rritur dhe 2 fëmijë në varësi (Lek)	145.017	160.742	170.785
Rreziku për të qenë i varfër përpara transfertave sociale (%) (Pensionet e pleqërisë dhe familjare përfshirë transfertat sociale)	304.535	337.558	358.650
Rreziku për të qenë i varfër përpara transfertave sociale (%) (Pensionet e pleqërisë dhe familjare pa transfertat sociale)	40,4	39,0	38,1
Shkalla e rrezikut për të qenë i varfër (%)	27,1	26,3	26,1

Burimi: Anketat e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, 2017, 2018, 2019

2.2 Potenciali i të ardhurave

Paga mesatare e grave është rreth 18% më e ulët se e burrave në zonat urbane dhe dyfish më e ulët në zonat rurale⁷. Gratë janë të mbipërfaqësuar në ekonominë informale shqiptare dhe në lëmin e punës së papaguar në biznese apo ferma familjare. Më shumë se 50% e grave shqiptare punojnë në bujqësi, ku 87% e tyre në punë të papaguara në familje, dhe gratë rurale nuk janë të mbuluara nga shërbime bazë sociale, pensioni dhe shëndetësore. Gratë kanë në pronësi ose menaxhojnë vetëm 28,5% të të gjitha sipërmarrjeve, shumica e të cilave janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme me kapital të pamjaftueshëm në sektorë tejet informale dhe me vlerë të shtuar të ulët.

Tabela 4: Pjesëmarrja në fuqinë punëtore

Grupmosha	Shkalla e pjesëmarrjes në fuqisë punëtore				
	2016	2017	2018	2019	2020
Gjithsej					
15-29	45.7	45.6	50.1	52.5	52.1
30-64	76.1	77.0	78.1	78.6	77.8
15-64	66.2	66.8	68.3	69.6	69.1
15+	57.5	58.3	59.4	60.4	59.5
Mashkull					
15-29	51.7	52.8	58.2	59.2	59.3
30-64	85.8	87.8	87.5	87.6	86.6
15-64	74.1	75.8	76.9	77.6	77.1
15+	65.0	66.8	67.6	68.0	66.9
Femër					
15-29	38.8	37.2	41.5	45.6	44.7
30-64	66.8	66.7	69.2	69.9	69.4
15-64	58.3	57.7	59.7	61.6	61.2
15+	49.9	49.8	51.4	53.0	52.3

Burimi: Anketat e Fuqisë Punëtore 2016-2020

7. UN Women Evropë dhe Azia Qendrore.


Të dhënat e vitit 2020 tregojnë se grupmosha 15-29 vjeç ka dallimin më të madh të punësimit ndërmjet femrave dhe meshkujve (35,3% dhe 46,9%) në vitin 2020.

Tabela 5: Shkalla e punësimit

Grupmosha	(%)				
	2016	2017	2018	2019	2020
Gjithsej					
15-29	32.4	33.8	38.5	41.2	41.2
30-64	67.2	68.7	70.9	71.8	70.7
15-64	55.9	57.4	59.5	61.2	60.6
15+	48.7	50.3	52.1	53.4	52.5
Mashkull					
15-29	36.3	38.5	44.7	46.6	46.9
30-64	75.4	77.9	79.3	79.9	78.9
15-64	61.9	64.3	66.7	68.2	67.8
15+	54.7	57.1	59.0	60.1	59.2
Femër					
15-29	28.0	28.3	32.0	35.7	35.3
30-64	59.3	60.0	62.9	64.0	62.8
15-64	49.7	50.3	52.4	54.4	53.6
15+	42.8	43.5	45.3	46.9	46.1

Burimi: Anketat e Fuqisë Punëtore 2016-2020

Gjatë periudhës 2013-2019 përqindja e grave dhe burrave në tregun e punës në Shqipëri u rrit përkatësisht nga 50,1% në 61,1% dhe nga 70,2% në 77,6% përkatësisht. Pavarësisht rritjes së përqindjes së veprimtarisë së grave, hendeuku gjinor ka vijuar të jetë i pranishëm në një masë mesatare prej 18 pikë përqindje.



Papunësia në Shqipëri është kryesisht afatgjatë dhe strukturore, duke qenë se 66% e të papunëve janë të papunë afatgjatë. Gratë, të rinjtë dhe personat me nivel të kufizuar arsimit janë individët më të përjashtuar nga punësimi.

Tabela 6: Papunësia

Grupmosha	Përqindja e papunësisë				
	2016	2017	2018	2019	2020
Gjithsej					
15-29	28.9	25.9	23.1	21.5	20.9
30-64	11.8	10.8	9.2	8.7	9.2
15-64	15.6	14.1	12.8	12.0	12.2
15+	15.2	13.7	12.3	11.5	11.7
Mashkull					
15-29	29.7	27.0	23.1	21.3	20.8
30-64	12.2	11.3	9.4	8.8	8.8
15-64	16.4	15.1	13.2	12.2	12.0
15+	15.9	14.6	12.7	11.6	11.5
Femër					
15-29	27.8	24.0	23.1	21.7	21.1
30-64	11.2	10.1	9.0	8.5	9.6
15-64	14.6	12.8	12.3	11.8	12.4
15+	14.4	12.6	11.9	11.4	11.9

Burimi i informacionit: Anketat e Fuqisë Punëtore 2016-2020

Kjo prirje me mundësi të pakësuar për gjenerim të ardhurash përmes punësimit, që përkeqësohet më tej nga qëndrimet zakonore, krijon varësi ekonomike dhe i detyron gratë të qëndrojnë në marrëdhënie të dhunshme.

2.3 COVID-19 dhe Ndikimi i tij Socio-Ekonomik mbi Grupet e Cenueshme

Pandemia e COVID-19 ka krijuar veçanërisht një botë me pabarazi ekstreme. Edhe në Shqipëri, këto pabarazi janë shumëfishuar dhe ekspozuar. Gratë janë ndër grupet më të ndikuar ekonomikisht, sepse ato janë të përfshira më shumë në punë informale. Në këtë situatë, pandemia e COVID-19 ka krijuar presion gjithnjë e më të madh mbi sistemet e mbrojtjes sociale, duke shkaktuar ndalesa madhore të proceseve ekonomike dhe kufizime në jetën shoqërore, duke thelluar pabarazitë dhe duke treguar se sa të cenueshme janë gratë dhe vajzat, përfshirë fëmijët.

Sipas një studimi, të vetëpunësuarat u ndikuan më shumë nga mbyllja, në lidhje me punën e tyre. Gratë vuajtën rënie të konsiderueshme, veçanërisht sa i përket të ardhurave nga bujqësia dhe remitancat⁸. Studimi tregoi se një në dy gra të punësuar (51%) ka punuar në distancë (nga shtëpia), krahasuar me rreth një në katër burra (27%). Si pasojë, pandemia nxiti prirje dhe role tradicionale gjinore brenda familjes shqiptare, ose në fjalë të tjera, punën e papaqur. Për shembull, përqindja e individëve që raportuan se kaluan më shumë kohë në gatim gjatë mbylljes ishte 29,8%, ndërsa 53,8% e të intervistuarve deklaruan më shumë kohë në pastrim në familje⁹.

8. Shihni skedën e fakteve të UN Women në: <https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/2020/07/factsheet-albania-fin-min.pdf?la=en&vs=1208>.

9. Po aty.

Për më tepër, raporti tregoi se pjesa e grave që duhet të reduktonin orët e punës kaloi me 4,7 pikë përqindje (krahasuar me burrat) për të punësuarit dhe me 2,8 pikë përqindje për të vetëpunësuarit. Gratë e vetëpunësuarat të grupmoshës 45-54 vjeç përfaqësojnë shumicën (66,7 përqind) të grave që kanë hasur ulje të kohëzgjatjes së punës. Ndër gratë e vetëpunësuarat, ato që jetojnë në familje me fëmijë (46 përqind) kanë shkurtuar kohëzgjatjen e tyre të punës, kryesisht për t'u kujdesur për fëmijët, apo për të kryer punët e shtëpisë. Sipas një studimi¹⁰, gratë e vetëpunësuarat të grupmoshës 45-54 vjeç raportuan përqindjen më të lartë (66,7%) ndër të gjitha gratë që kanë përjetuar shkurtim të kohëzgjatjes së punës. Ndër gratë e vetëpunësuarat, gratë që jetojnë me fëmijë (46%) u përballën me shkurtim të kohëzgjatjes së punës, kryesisht për shkak të përgjegjësive të kujdesit dhe atyre familjare. Kështu, pavarësisht situatës së punësimit, gratë janë më të ekspozuara ndaj sfidave që lidhen me shkurtimin e kohëzgjatjes së punës dhe humbjes së mundshme të të ardhurave. Raporti gjithashtu thekson situatën e punës së papaguar të kujdesit të grave gjatë pandemisë. Për shembull, koha e gatimit u rrit për 41% të grave, ndërsa koha e kaluar në pastrim u rrit për 66% të tyre, koha për të luajtur, mësuar dhe kujdesur për fëmijët u rrit për 35% të grave, dhe për një përqindje të madhe grash u rrit koha e shpenzuar për mbështetje emocionale për pjesëtarët e rritur të familjes së tyre.

Si përfundim, pandemia COVID-19 ka hedhur dritë mbi përvojën e shumë prindërve me ekulibrimin e kujdesit të papaguar dhe përgjegjësive të tyre të punës, përfshirë mangësitë e sistemit aktual të ofrimit të kujdesit të papaguar, përfshirë aksesin e pabarabartë, cilësinë e dobët, nevojën për financime publike, kushtet jo të mira dhe informalitetin e punësimit të fuqisë punëtore, dhe cenueshmërinë e përgjithshme të sektorit.

Me qëllim trajtimin e situatës së mësipërme, është e rëndësishme që shpenzimet publike (buxhetimi me ndjeshmëri gjinore) të riorganizohen nga një këndvështrim gjinor në kontekstin e pandemisë, si dhe të ketë rishpërndarje dhe priorizim të ndërhyrjeve me qëllim zbutjen e efekteve negative të punës së papaguar të kujdesit mbi gratë dhe fëmijët në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë.

2.4 Dimensioi Gjinator i Informalitetit, Punës së Padeklaruar, Punës së Papa-guar të Kujdesit

Në Shqipëri, struktura e punësimit dhe niveli i lartë i informalitetit përjashtojnë më shumë se gjysmën e punonjësve nga gëzimi i të drejtave të tyre të punës. Përqindja e lartë (52,9% në vitin 2017) e punonjësve me kontribut personale dhe pjesëtarëve kontribuues të familjes tregon një nivel të lartë cenueshmërie (mungesë aksesin në të drejta të plota punësimi, sigurime shoqërore apo sigurime shëndetësore) dhe një nënpunësim të konsiderueshëm (punonjës sezonal, sipas rastit, shtëpiakë dhe rastësor). Sfidat më të mëdha është sasia e konsiderueshme e punës së padeklaruar, qoftë ky punësim pa kontratë, punësim për të cilin nuk paguhen kontributet shoqërore, apo punësim me raportim page më të ulët se fakti. Përqindja e punësimit informal në sektorët jobujqësorë është 30,3%. Kështu, në vitin 2019 përqindja e punësimit informal në Shqipëri në kuadër të punësimit të përgjithshëm jobujqësor ishte 35,6% për burrat dhe 21,8% për gratë, dhe këto nivele nuk kanë pësuar ndryshime madhore që prej vitit 2017¹¹.

Sipas të dhënave jo shkencore, gratë në Shqipëri janë më të tërhequra nga industria e kujdesit. Megjithatë inkurajon punësimin, industria e kujdesit nënkupton zakonisht informalitet, mungesë stabiliteti dhe paga shumë të ulëta, duke i vendosur kështu gratë në një pozicion gjithnjë e më të cenueshëm. Sistemet aktuale të mbrojtjes sociale në Shqipëri i identifikojnë dhe i përgjigjen me vështirësi nevojave të grave dhe vajzave, nuk njohin dhe vlerësojnë kujdesin dhe punën shtëpiake të papaguar, nuk mundësojnë mobilitetin e grave dhe vajzave, në veçanti sa i përket punësimit të tyre të plotë dhe produktive dhe punës dinjitoze¹². Për më tepër ato nuk identifikojnë se gratë dhe vajzat shpesh ndërmarrin një pjesë jo proporcionale të kujdesit dhe punës shtëpiake të papaguar, përfshirë kujdesin për fëmijën, të moshuarit dhe personal me aftësi të kufizuara, dhe ato vijojnë të jenë të nënvlerësuara. Kjo ndarje e pabarabartë e përgjegjësive midis grave dhe burrave është një pengesë e konsiderueshme për gratë lidhur me vijimin apo përfundimin e arsimit dhe formimit, hyrjen apo rihyrjen, dhe përparimin në tregun e punësimit të paguar dhe mundësitë e tyre ekonomike e veprimtaritë sipërmarrëse, si dhe çon në hendeqe në kuadër të mbrojtjes sociale.

Gjithashtu, nuk pranohet gjerësisht nevoja për zbatimin e masave për pakësimin dhe rishpërndarjen e pjesës

10. Ndikimi i Covid-19 mbi Jetën e Grave dhe Burrave dhe mbi Jetesën në Shqipëri, 2020

11. INSTAT (2020). Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2020.

12. ILO 2019.

joproporcionale të punës së papaguar të kujdesit, duke nxitur ndarjen e barabartë të përgjegjësive ndërmjet grave dhe burrave në familje përmes politikave të përshtatshme kombëtare të mbrojtjes sociale, përfshirë shërbimet e kujdesit, kujdesin për fëmijën, dhe lejen e lindjes për nënat, baballarët apo prindërit¹³.

Kështu, Shqipëria përballet me sfida lidhur me një sërë treguesish të mbështetjes sociale, si mundësitë e barabarta, aksesin në tregun e punës për shkak të punës së papaguar, dhe mbrojtja dhe përfshirja sociale. Për shembull, sistemi i mbrojtjes sociale nuk është i përshtatshëm dhe nuk arrin të mbulojë personat në nevojë. Megjithatë ka ndihmë ekonomike, vlera e pagesave nuk është e mjaftueshme për të parandaluar varfërinë.

COV

Sipas anketimit të fuqisë punëtore të ILO-s për vitin 2019, punësimi informal arriti në 56,7%. Tabela 5 paraqet përbërjen e punësimit informal sipas seksit, ku 92,3% e grave janë të angazhuara në sektorin informal, veçanërisht në bujqësi. Ky tregues hedh dritë mbi cenueshmëritë ekzistuese të grave dhe vajzave.

Tabela 7: Përbërja e punësimit informal sipas seksit (%)

	Burra	Gra	Gjithsej
Punësimi informal (%) nga ku:	59,0	53,9	56,7
- Në sektorin informal	73,3	57,8	66,7
- Në sektorin formal	0,6	1,0	0,7
- Në familje	26,2	41,2	32,5
Njësitë e sektorit informal (%)	96,5	95,7	98,3
Punësimi informal, përjashtuar bujqësinë	39,9	21,2	32,2
- Në sektorin informal	88,4	82,5	86,8
- Në sektorin formal	1,2	3,9	1,9
- Në familje	10,4	13,6	11,3
Njësitë e sektorit informal, përjashtuar bujqësinë (%)	92,8	92,3	94,7

Burimi: Anketa e Fuqisë Punëtore e ILO, 2019

Puna e papaguar

Shqipëria është një prej pesë vendeve me përmirësimin më të mirë në indeksin e përgjithshëm të hendekut gjinor. Pavarësisht kësaj, pjesa e punës së papaguar në ditë zë 21,74 përqind të kohës për gratë dhe vetëm 3,47 përqind për burrat, që do të thotë se gratë nuk paguhen për thujse çerekun e punës së kryer, qoftë kjo në familje apo në vendin e punës. Gratë shqiptare kalojnë 21,74 përqind të ditës së tyre duke kryer punë të papaguar, si gatim, pastrim dhe kujdes për fëmijët dhe pjesëtarët e familjes. Gruaja mesatare shqiptare ka 1,62 fëmijë dhe lindjen e parë e kryen në moshën 27,5 vjeç. Si krahasim, burrat shqiptarë kalojnë vetëm 3,47% të ditës së tyre duke bërë punë për të cilën nuk paguhen. Sipas një studimi për punën e papaguar riprodhuese, burrat shqiptarë kontribuojnë vetëm 14,2% të të gjithë punës së papaguar të kujdesit, ndërsa gratë kalojnë më shumë se pesë orë çdo ditë me punë të papaguar shtëpie. Kjo shifër është konsiderueshëm më e ulët krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Për shembull, në Maqedoninë e Veriut dhe në Serbi pjesa e burrave në punën e papaguar të kujdesit është përkatësisht 27,5% dhe 33,0%.

Puna e papaguar përbën rreth 60% të PBB-së në Shqipëri. Nëse supozojmë se një punëmarrës mesatar shqiptar punon 47 orë në javë, kjo korrespondon me 40 orë në muaj për një grua, rreth një janë e tërë pune pa pagesë. Vlera e kësaj pune është 84 USD (71 Euro) bazuar në pagën mesatare mujore prej 390 USD (330 Euro), dhe kur merret në konsideratë se 35% e rreth 1,08 milion grave në Shqipëri janë të punësuar, ekonomia shqiptare po humb një potencial prej 32 milion USD (27 milion

13. UNFPA 2020.

Euro çdo muaj. Kjo përkthehet në një shumë prej 385 milion USD (324 milion Euro) në vit. Nëse merret në konsideratë e gjithë fuqia punëtore gra, kjo shifër rritet në 1,20 miliard USD (1 miliard Euro) çdo vit.

Punësimi informal përbën rreth 61% të të gjithë punësimit në Shqipëri dhe kriza si ajo e COVID-19 theksojnë cenueshmërinë e punonjësve informale dhe hendekun e pabarazisë në ekonomi që i shtyn shumë njerëz, veçanërisht gratë e përfshira më shumë në kujdesin e papaguar, në varfëri.

Ka gjithashtu problematika që lidhen me përqendrimin e grave në sektorë me segmente të mëdha informaliteti, si bujqësia, turizmi dhe industritë e tekstilit dhe këpucëve, ku ato nuk kanë mbrojtje të përshtatshme në punë dhe sociale. Megjithatë, mungesa e të dhënave jep kontribut në përjashtimin e një numri të konsiderueshëm grash nga skemat e mbrojtjes sociale, duke i vënë ato akoma më shumë në rrezik për të qenë të varfra gjatë viteve të lindjes së fëmijëve, pas ndarjes apo vdekjes së bashkëshortëve, dhe veçanërisht në pleqëri.

Sektori i bujqësisë është i karakterizuar nga bujqësia familjare për mbijetesë, të ardhura shumë të ulëta dhe niveli i lartë i informalitetit, që janë pengesë ndaj punës dinjitoze. Shumica dërrmuese e grave punojnë në punë të papaguara informale familjare, dhe kontributi i tyre kompensohet me shumë pak para, ndërsa puna e tyre e papaguar pranohet dhe vlerësohet rrallë. Gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në informacion bujqësor dhe mbi tregun, dhe përballen me nivele të larta pabarazie gjatë vendimmarrjes në familje. Për më tepër, gratë rurale duhet të kryejnë të gjitha punët e shtëpisë dhe në fermë, veçanërisht kur pjesëtarët meshkuj të familjes punësohen në sektorë të tjerë ose emigrojnë për të kërkuar punë.

Kujdesi për fëmijën

Sistemet e mbrojtjes sociale luajnë rol thelbësor në uljen e varfërisë, pabarazive dhe pengesave që nuk i lejojnë familjeve dhe fëmijëve të kenë akses në shërbime. Në këtë kuadër, programet aktuale të mbrojtjes sociale nuk arrijnë të trajtojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse cenueshmëritë e shumëfishta me të cilat përballen fëmijët dhe familjet.

Për shembull, fëmijët në Shqipëri nuk kanë mbikëqyrje të përshtatshme. Kjo nuk ka të bëjë me dashurinë e prindërve, por me realitetin e elementeve që konkurrojnë për kohën dhe burimet. Në Shqipëri, pjesa e fëmijëve nën moshën pesëvjeçare në përgjithësi, dhe nga 20 përqindësi më i pasur dhe ai më i varfër që kalojnë kohë pa mbikëqyrje nga të rriturit, ishte nën mesataren¹⁴. Deficiti i kujdesit për fëmijën përkeqësohet kur bëhet fjalë për varfërinë shumëdimensionale. Prindërit, dhe veçanërisht nënat, priten të investojnë shumë për rritjen e fëmijëve, duke kaluar shumë 'kohë cilësore/mbikëqyrjeje' me fëmijët dhe duke bërë përpjekje të vazhdueshme për të pasuruar mjedisin e fëmijëve. Por, për shkak të presioneve të shtuara ndaj gruas për të dhënë kontribut në mirëqenien ekonomike të familjes, rolet tradicionale gjinore të cilat i caktojnë grave përgjegjësinë parësore për punën e papaguar (pra punët e shtëpisë dhe dhënien e kujdesit) janë zhbërë.

Kur merret në konsideratë ofrimi i kujdesit për fëmijën në të njëjtën kohë me veprimtari të tjera, hendeku gjinor që lidhet me kohëzgjatjen e këtyre veprimtarive është më i madh se sa kur kujdesi për fëmijën konsiderohet si veprimtari parësore e vetme. Për shembull, puna e papaguar e grave në Shqipëri zë 314 minuta/ditë për gratë dhe 52 minuta/ditë për burrat.¹⁵ Koha është burim i kufizuar, që do të thotë se koha e kaluar me një veprimtari pakëson kohën e disponueshme për veprimtari të tjera. Bazuar në këtë, nuk janë vetëm fëmijët pa mbikëqyrje që po vuajnë çmimin, por edhe gratë kanë 'humbje' që vjen në formën e orëve të gjata, të ardhurave të ulëta dhe mundësive të humbura.

14. Bazat e të dhënave botërore të UNICEF-it, 2014.

15. Baza e të dhënave botërore të zhvillimit të njerëzimit e UNDP, 2016.

Kutia 1: Puna e papaguar e kujdesit

- Vlera ekonomike e punës së papaguar të kujdesit është sa 60% e PBB-së.
- Gratë bëjnë punën të papaguar mujore që arrijnë një vlerë të barasvlershme prej 32 milion USD.
- Pjesëtarët e familjes kalojnë orë të tjera shtesë çdo ditë.
- Asnjë vend nuk ka arritur një ndarje të barabartë të punës së papaguar të kujdesit.
- Përparimi për ngushtimin e kujdesit të papaguar ka qenë i ngadaltë.
- Burrat janë më të përfshirë në punë të papaguar se më parë (kryesisht në veprimtari shtëpiake si blerjet, riparimet në shtëpi, dhe me fëmijët) megjithatë ka hendeqe në mbikëqyrje.

Kutia 2: Vlera e punës së papaguar të grave në Shqipëri

- Gratë në Shqipëri punojnë në punë të papaguar për 314 minuta në ditë (2016).
- Puna e papaguar përbën rreth 60% të PBB-së në Shqipëri.
- Gratë humbin paga mujore mesatare prej 390 USD (330 Euro) në muaj ose rreth 1,20 miliard USD (1 miliard Euro) në vit.



Burimi: Analiza dhe përlogaritjet e autorit

3. Panoramë e dimensioneve gjinore të mbrojtjes sociale në Shqipëri

Shqipëria mund të kategorizohet në shumë aspekte: Shqiptarët dallohen bazuar në cilësi si pasuria, arsimi, vendbanimet urbane dhe rurale, seksi, mosha, grupet e solidaritetit me bazë familjen, lidhjet politike, etnia dhe të tjera. Si rrjedhojë, përfshirja sociale është një temë e rëndësishme në shoqërinë shqiptare. Aksesit i individëve dhe grupeve në burime ekonomike, sociale dhe politike është më së shumti i pabarabartë. Si pasojë nevojitet vëmendje dhe mbështetje e veçantë për përfshirjen e grupeve të veçanta, si: grupet e marginalizuara dhe të cenueshme, të varfrit, dhe Romët dhe Egjiptianët, si dhe personat me aftësi të kufizuara, si pjesë të rëndësishme të këtyre grupeve.

Sistemet shqiptare të kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes sociale nuk mbrojnë njerëzit në mënyrë të mjaftueshme nga goditjet e varfërisë, dhe kanë vështirësi të ndihmojnë të varfrit të gjejnë sistemime të qëndrueshme. Investimet në arsim, kujdes shëndetësor dhe mbrojtje sociale janë nën mesataren e BE-së si përqindje të PBB-së.

3.1 Fuqia Negociuese dhe Puna e Papaguar e Kujdesit


Indeksi i Barazisë Gjinore paraqet një hendek të gjerë midis grave dhe burrave në veprimtaritë e kujdesit në Shqipëri, veçanërisht sa i përket individëve që raportojnë punë kujdesi çdo ditë me fëmijët, nipërit, të moshuarit, apo personat me aftësi të kufizuara: 51,1% e grave shqiptare krahasuar me 26,4% të burrave shqiptarë.

Gratë janë më të përfshira sa i përket pjesëmarrjes dhe kohës së kushtuar punës së papaguar të kujdesit. Me gjithë përmirësimet e kohëve të fundit, puna e papaguar e kujdesit dhe puna shtëpiake në Shqipëri, i janë caktuar grave edhe nga këndvështrimi kulturor, dhe shpesh pritet që gratë të kujdesen për fëmijët dhe të afërmit e moshuar pas asnjë njohje apo pagesë. Studimi tregon se ndikimi i këtij lloji pune të papaguar është tejet i gjerë dhe kompenson mungesën e shpenzimeve publike për shërbimet dhe infrastrukturën e kujdesit (Organizata Ndërkombëtare e Punës, 2018). Megjithatë, puna e grave në shtëpi injorohet në shoqëri dhe fuqizimi i grave matet përmes pranisë së tyre në tregun e punës, që arrihet duke ia transferuar punët e shtëpisë dhe kujdesin për fëmijëve të tjetër, që janë zakonisht gra me gjendje socio-ekonomike më të dobët (Kisner, 2021). Zhvlerësimi i punës shtëpiake në banesë nuk është aksidental, sepse ku zhvlerësim rrënjësor më tej idetë patriarkale që janë në themel të shumë shoqërive. Për më tepër, ndarja e pabarabartë e punës së papaguar të kujdesit, ku barra më e madhe i bie grave, është në përputhje me normat e krijuara shoqërore që e shohin gruan si “mëkuese, sakrifikuese të vetes dhe të kujdesur, ndërkohë që i sheh burrat si ata që nxjerrin bukën” (King et. al. 2020, fq. 80).

Një studim i UNDP-së mbi perceptimet e barazisë gjinore në Shqipëri (2016) doli në përfundimin se më shumë se 80% e të intervistuarve deklaruan se punët e shtëpisë - hekurosja, gatimi, pastrimi, larja e rrobave dhe enëve, kishin më shumë gjasa të bëheshin nga gratë. Studimi arriti në gjetjen se mesatarisht, gratë kalonin 4,66 orë vetëm me punët e shtëpisë, krahasuar me 2,07 orë për burrat. Nuk ka dallim me rëndësi statistikore ndërmjet rajoneve: të intervistuarit në zonat rurale (si burrat ashtu edhe gratë) deklaruan se kalojnë më shumë kohë me punët e shtëpisë se burrat dhe gratë në zonat urbane (3,86 orë dhe 2,96 orë përkatësisht).

Pabarazia gjinore është një nga sfidat më të mëdha me të cilën përballen politikëbërësit shqiptarë tek mundohen të arrijnë rritje më të shpejtë, më të qëndrueshme dhe më përfshirëse. Në veçanti, ndarja në bazë të gjinisë në tregun e punës është një nga shqetësimet kyçe. Për shembull, shkalla e pjesëmarrjes së grave shqiptare në fuqinë punëtore është. Për më tepër, ato paguhen me paga më të vogla, janë të mbipërfaqësuar në punën informale dhe të papaguar shtëpiake, përballen me hendeqe gjinore në një sërë dimensionesh, përfshirë arsimin, aksesin në inpute prodhuese dhe pushtet negociues në shtëpi (Figura 2).


Figura 2: Koha e kaluar me punë të papaguar kujdesi sipas numrit dhe moshës së fëmijëve në familje (gratë)



Burimi: Puna e Papaguar e Kujdesit dhe Tregu i Punës, ILO 2019

Sipas studimit të ILO-së, me rritjen e nivelit të tyre arsimor, gratë i kushtojnë gjithnjë e më shumë kohë punës së paguar. Në fjalë të tjera, koha e punës së papaguar të kujdesit bie me rritjen e nivelit arsimor. Gjithashtu, sipas nivelit të tyre arsimor, gratë marrin pjesë në fuqinë punëtore, kryesisht në punësim informal sipas nevojave.


Figura 3: Koha e kaluar në punë të papaguar kujdesi sipas nivelit arsimor (gratë)



Burimi: Puna e Papaguar e Kujdesit dhe Tregu i Punës, ILO 2019

Gjithashtu, raporti tregon se rreth 50% e të intervistuarve deklaruan se ato kujdesen për fëmijët e tyre dhe për bashkëshortin/partnerin e tyre (Figura 4). Megjithatë, gratë kishin më shumë gjasa se burrat të deklarorin se ato kujdesen për fëmijët dhe nuk kanë asnjë mbështetje nga bashkëshortët e tyre. Gratë dhe burrat kishin më shumë gjasa të ndanin përgjegjësit e kujdesit për fëmijën në raste të emergjencave shëndetësore.

Figura 4: Numri mesatar i orëve të kaluara në punë shtëpie sipas gjinisë




Burimi: Puna e Papaguar e Kujdesit dhe Tregu i Punës, ILO 2019

Figura 5 tregon punën e papaguar të kujdesit sipas gjinisë.

Figura 5: Kujdesi për fëmijën sipas gjinisë

■ Burra ■ Gra



Burimi: Puna e Papaguar e Kujdesit dhe Tregu i Punës, ILO 2019

Studimi tregon prirje të një ndarje tejet joproportionale të punës midis burrave dhe grave, që shihet si në zonat urbane, ashtu edhe rurale, çka ka ndikime serioze mbi të drejtat dhe liritë e grave në mbarë Shqipërinë. Kjo sugjeron që puna e papaguar nënkupton se gratë kanë më pak mundësi arsimore dhe ekonomike, akses të kufizuar në kujdes shëndetësor dhe sigurime shoqërore, dhe janë më të cenueshme nga diskriminimi.

Panoramë e sistemit fiskal për mbrojtjen sociale në Shqipëri

Zakonisht, hapësira fiskale përkufizohet si 'hapësira e buxhetit të shtetit që i mundëson të sigurojë burime për një qëllim të dëshiruar pa vënë në rrezik qëndrueshmërinë e pozicionit të vet financiar, apo stabilitetin e ekonomisë' (Heller, 2005) dhe si "financat që janë në dispozicion të qeverisë si pasojë e veprimeve konkrete të politikave për fuqizimin e mobilizimit të burimeve (Roy et. al., 2007).

Kuadri i zhvillimit të politikave i qeverisë shqiptare është i bazuar në Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), që përbëhet nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), si dokumenti themelor i politikave, dhe Programi i Buxhetit Afatmesëm (PBA), si dokumenti kryesor i buxhetit. Kuadri buxhetor në Shqipëri përbëhet nga një plan vjetor dhe program afatmesëm buxheti (PBA) me kohëzgjatje 3 vjeçare, duke përfshirë buxhetin vjetor dhe dy vitet pasardhëse.

Në këtë kontekst, qeveria shqiptare ka shpenzuar mesatarisht 0,97% të PBB-së për varfërinë në periudhën 2015-2017. Shpenzimet mbizotërohen nga pagesat e përfitimeve në para, që përbëjnë rreth 94-95% të shpenzimeve totale. Programi i ndihmës ekonomike është i përbërë nga dy nënprograme kryesore: pagesa e ndihmës ekonomike për lehtësimin e varfërisë (ndihma ekonomike) dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuara për të ndihmuar me mbulimin e kostove të kujdesit dhe për të kompensuar pamundësinë e tyre për të punuar, të cilat administrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale¹⁶.

4.1 Panoramë e Përpjekjeve të Buxhetimit me Ndjeshmëri Gjimore

Buxheti gjinor është mbështetur vazhdimisht në Shqipëri gjatë viteve të shkuara. Janë bërë një sërë përpjekjesh, veçanërisht lidhur me ndryshime institucionale për buxhetimin gjinor. Gjithashtu, shoqëria civile ka bërë përpjekje të dukshme për sigurimin e analizave të ekspertëve gjinorë dhe për shtrirjen e debatit mbi politikat fiskale, duke treguar se buxheti gjinor jep kontribut për rezultate të mira për gratë dhe fëmijët, veçanërisht sa i përket përfitimeve shoqërore dhe ekonomike që lidhen me barazinë dhe fuqizimin ekonomik të grave. Theksohet se nismat e buxhetimit gjinor zbatohen më së shumti në kuadër të integritimit gjinor.

Shpenzimet për barazinë gjinore në Shqipëri janë modeste dhe përbëjnë 0,05 përqind të PBB-së¹⁷. Duket se projekte e posaçme për gjininë marrin pjesë të vogla të buxhetit të qeverisë dhe nuk janë shumë të dukshme, duke qenë se planifikohen dhe zbatohen në nivel nënprogrami apo produkti të buxhetit, të cilat nuk janë ende të disponueshme në sistemet e informacionit financiar të qeverisë. Për më tepër, çështjet e pabarazisë gjinore në sektorë si shëndetësia, mbrojtja sociale, arsimi, drejtësia, biznesi dhe bujqësia trajtohen në kuadër të 38 Programeve Buxhetore, ose 50% e të gjitha programeve buxhetore që përfshihen në Programin e Buxhetit Afatmesëm (PBA) 2020-2022. Gjithashtu, elementet e buxhetit të përgjigjshëm gjinor përbëjnë 7,2% të buxhetit të përgjithshëm vjetor (38.264.748 Lek), krahasuar me vetëm 1% në vitin 2015¹⁸. Megjithatë, financimi i përshtatshëm për barazinë gjinore mbetet një sfidë në kontekstin e pandemisë dhe në kuadër të zbutjes së efekteve negative në punës së papaguar të kujdesit mbi gratë dhe fëmijët.

16. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) deri në vitin 2017; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) prej vitit 2017.

17. Bazuar në buxhetin e shtetit për vitet 2015, 2016 dhe 2017.

18. Raporti për Monitorimin e Buxhetimit Gjinor për trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në Shqipëri në vitin 2018.

Sipas dokumenteve të buxhetit, produktet e përgjigjshme gjinore ishin në vlerën e 4,8 miliard Lek, ose rreth 1,4% e buxhetit të vitit 2015, duke u rritur në 3,2% të buxhetit në vitin 2017¹⁹. Tabela 8 jep informacion të detajuar.

Tabela 8: Produktet e buxhetimi të përgjigjshëm gjinor (2015 - 2017)

Ministritë e linjës	Shpenzime për Produkte me Përgjigjshmëri Gjinore 2015	Shpenzime për Produkte me Përgjigjshmëri Gjinore 2016	Shpenzime për Produkte me Përgjigjshmëri Gjinore 2017
			(in 000 LEK)
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarjes	14.000	30.000	20.000
Ministria e Zhvillimit Urban	-	2.034	2.000
Ministria e Kulturës	12.916	44.418	82.200
Ministria e Integritimit Evropian	28.719	28.020	2.200
Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	23.941	23.941	25.300
Ministria e Arsimit dhe Sportit	-	160.000	250.400
Ministria e Drejtësisë	-	582.408	535.443
Ministria e Punëve të Brendshme / Policia e Shtetit	750	417.075	280.929
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	4.762.440	5.800.047	5.510.265
Ministria e Shëndetësisë	-	770.000	8.395.626
Ministria e Mjedisit	-	-	30.328
Ministria e Financave			1.835
Totali i planifikuar sipas vitit	4.842.766	7.857.943	15.136.526
Nga të cilat: Programi i NE që vlen për të gjithë pjesëtarët e familjes	4.700.000	4.506.416	4.506.416
Nga të cilat: Programi i kontrollit shëndetësor parësor i hapur për të gjithë popullsinë në moshë madhore			8.294.496

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe UN Women

Në Shqipëri, ushtrimi i buxhetimit gjinor zakonisht lidhet me krahun e shpenzimeve të buxhetit, dhe në veçanti me shpenzimet që lidhen me ofrimin e shërbimeve publike. Në shumicën e rasteve, ai nuk trajton krahun e të ardhurave, siç janë tatimet për objektivat e barazisë gjinore. Për shembull, ka anshmëri të fshehur gjinore në tatimet që lidhen me shitjen, duke zbatuar TVSH për produkte gjinore, dhe në veçanti për familjet me kryefamiljare femra përfshirë përfundimin e krediteve për punën e papaguar të kujdesit. Politikat që lidhen me faktin nëse të ardhurat nga tatimet duhet të rriten dhe si të rriten mund të rezultojnë në barrë të ndryshme për burrat dhe gratë, si dhe mund të kenë efekt mbi programet sociale, që i ndihmojnë gratë të ekuilibrojnë punën e paguar dhe atë të papaguar. Në kontekstin e COVID-19, me gjithë veprimtarinë e kryer lidhur me buxhetimin gjinor, politikëbërësit nuk kanë marrë mjaftueshëm në konsideratë barazinë gjinore në kuadrin e hartimit të masave shtrënguese të kohëve të fundit.

Në përgjithësi, dobësitë lidhur me efektshmërinë e buxhetimit gjinor mund të shihen në elementë të tillë si vlera buxhetore e caktuar për barazinë gjinore, dhe ndryshimet në buxhet dhe politikëbërje. Në veçanti, buxhetimi gjinor në Shqipëri nuk ka arritur të nxisë miratimin e politikave për përmirësimin e barazisë gjinore, përfshirë zhvillimin e fëmijëve, veçanërisht në fushat e mëposhtme:

19. Të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

- Arsim
- Tregu i punës për trajtimin e punës së papaguar të kujdesit
- Pabarazi në të ardhura
- Mirëqenie
- Kujdes për fëmijën dhe kujdes në familje
- Shëndetësi

Si pasojë, efekti i kombinuar dhe risku në sistemet e mbrojtjes sociale, si dhe papunësia e grave janë në nivele të larta, ndërkohë që rreziku për të qenë i varfër rritet për këto gra në periudhën afatgjatë. Në këtë pikëpamje, koordinimi i synimeve të barazisë gjinore me buxhetimin gjinor mund të përmirësohen ndjeshëm, përfshirë ndryshime legjislative, administrative dhe metodologjike në institucionet buxhetore, veçanërisht lidhur me hartimin e buxheteve me ndjeshmëri gjinore. Gjithashtu, ka mundësi të madhe që politikëbërja fiskale të bëhet politikëbërje miqësore me gjininë, efikase dhe të efektshme.


Është e rëndësishme që buxheti me ndjeshmëri gjinore të përqendrohet në krahun e të ardhurave për të trajtuar fusha si:

- Punësimi - shtimi i punësimit gjinor në kujdesin e papaguar dhe shtimi i mbrojtjes në informalitet
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe burimeve të barazisë për gratë
- Sisteme për trajtimin e kujdesit të papaguar, përfshirë kujdesin universal për fëmijët.

4.2 Analiza e Disponueshmërisë së Burimeve për Mbrojtjen Sociale në Shqipëri

Sipas analizës së të dhënave për periudhën 2003-2018, disponueshmëria e burimeve të brendshme dhe të jashtme është në rreth 25% të PBB-së me një prirje rritëse me kalimin e kohës, ndërsa burimet e jashtme kanë pësuar rënie nga 6% e PBB-së në vitin 2003 në 2,3% të PBB-së në vitin 2018. Në këtë kontekst, ODA e shpenzuar në sektorin e mbrojtjes sociale është një pjesë e vogël e ODA-së së përgjithshme. Shpenzimet e financuara me fonde ndihme për mbrojtjen sociale, si pasojë janë në vlera shumë të vogla krahasuar me shpenzimet e qeverisë për mbrojtjen sociale. Alokimi i ODA-së për mbrojtjen sociale është i papërfillshëm, duke arritur për shembull në vetëm 5 milion USD ose 0,04% të PBB-së në vitin 2015²⁰.


Figura 6: Disponueshmëria e burimeve nga tatimet dhe ODA-të (2003-2018)



Burimi: Përllogaritje bazuar në të dhënat e Treguesve të Zhvillimit Botëror të Bankës Botërore

20. Të dhëna të OECD-së.

Figura 7: Të ardhura tatimore gjithsej (2010-2019)



Burimi: Ministria e Financave, Qeveria e Shqipërisë

Struktura e të ardhurave fiskale në Shqipëri mbështet fuqishëm në tatimet indirekte, si dhe në tatimet e drejtpërdrejta dhe kontributet shoqërore. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) paraqet një përqindje të konsiderueshme (rreth 35%) të të ardhurave të përgjithshme të qeverisë dhe përbën 10% të PBB-së. Sigurimet Shoqërore dhe Sigurimet Shëndetësore (5% e PBB-së), janë gjithashtu një burim i rëndësishëm të ardhurash qeveritare. Sa i përket shpenzimeve, mbrojtja sociale, arsimit dhe shëndetësia janë ndër kategoritë më të mëdha.

COVID-19 nuk ka ndryshuar vetëm stilin e jetesës dhe punën, por ka sjellë edhe një mori problematikash ekonomike në Shqipëri. Për shembull, parashikohet që ekonomia të tkurret me rreth 7,5% në vitin 2020 (krahasuar me 2,2% në vitin 2019), duke pasqyruar varësinë e saj nga turizmi dhe remitancat. Parashikohet që deficitin fiskal të rritet me rreth 7% të PBB-së dhe borxhi publik të shkonte pak mbi 80% të PBB-së në fund të vitit 2020. Tregtia, transporti dhe shërbimet e hotelierisë, që janë degë të rëndësishme të ekonomisë shqiptare pësuan rënie prej 27%. Turizmi që përbën më shumë se 20% të PBB-së në Shqipëri, ishte një nga sektorët më të ndikuar nga pandemia. Gjithashtu vendi përjetoi humbjen e 34.000 vendeve të punës dhe rritjen e papunësisë me 0.6% vit më vit, duke arritur në 12,5%, çka tregoi ngadalësimin e tregut të punës në Shqipëri.

Tabela 9: Treguesit e hapësirës fiskale për Shqipërinë

Vendi	Totali	(i) Shpenzimet qeveritare			(ii) Të ardhura		(iii) Sigurimet shoqërore	(iv) Ndihma Zyrtare për Zhvillim (ODA)	(v) Flukset e paligjshme financiare	(vi) Rezervat valutore	(vii) Borxhi (% e PBB 2013)		(viii) Deficiti Bu-xhetor	(ix) Infalioni (% e ndryshimit 2014)
		Shëndetësia	Edukimi	Mbrojtja	Totali	Taksa	(% e shpenzimeve për mbrojtjen sociale)	2012	2012	2013	Stoku i jashtëm	Totali	2014	
Shqipëria	32.8	2.8	-	1.5	26.1	-	-	2.8	1.4	21.8	60.1	3.2	-6.7	1.8

Burimi: Parashikimi Ekonomik Botëror i FMN-së (tetor 2014).

i. a Treguesit e Zhvillimit Botëror (2015).

b Përfaqëson vlerat mesatare të 2010-12 bazuar në përlogaritjet e autorit duke përdorur Kar dhe Spanjers (2014) "Rrjedhat Financiare të Jashtëligjshme nga Vendet në Zhvillim: 2003-2012", (Washington, D.C., Global Financial Integrity).

c Monitori Ekonomik Botëror i Bankës Botërore (Janar 2015).

d Raporti i kontributeve të sigurisë shoqërore me shpenzimet publike për mbrojtjen sociale (në % të PBB-së, viti i fundit i disponueshëm).

4.3 Shpenzimet për Mbrojtjes Sociale dhe Përshtatshmëria e Përfitimeve

Shqipëria ka një qasje realiste për ofrimin e mbrojtjes sociale për qytetarët e saj përmes sigurimeve shoqërore, ndihmës ekonomike dhe programeve të punësimit. Megjithatë, sistemet shqiptare të mbrojtjes sociale nuk i mbrojnë njerëzit në mënyrë të përshtatshme nga varfëria, nuk kanë ndjeshmërinë e duhur gjinore dhe kanë vështirësi të ndihmojnë të varfrit të gjejnë sistemime të qëndrueshme. Investimet në arsim, kujdes shëndetësor dhe mbrojtje sociale janë nën mesataren e BE-së si përqindje të PBB-së. Gjithashtu, mungesa e investimeve të përshtatshme në të gjitha fazat e mbrojtjes sociale, përfshirë rolet dhe përputhshmëritë e incentivave midis skemave të “sigurimeve shoqërore” (kontribute) dhe përfitimeve të “ndihmës shoqërore” në këto shtylla (p.sh. midis ndihmës shoqërore dhe programeve të punësimit) ngre pyetjen e efektshmërisë së politikave sociale, përfshirë shtrirjen dhe përmasat e cenueshmërisë së grave dhe fëmijëve. Kjo është përkeqësuar më tej nga pandemia e COVID-19 që ende vazhdon.

Sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri mbulon rreth gjysmën e popullsisë. Nivelet e shpenzimeve nga ana tjetër, mbeten të ulëta për shkak të vlerave tejet modeste të pensioneve dhe ndihmës ekonomike për varfërinë. Sipas të dhënave të FMN-së, vendi ka përjetuar rritje të shpenzimeve për mbrojtjen sociale në periudhën 2010 - 2016, kur shpenzimet për mbrojtjen sociale arritën në 1,2% të PBB-së në terma nominalë dhe në 1,1% të terma realë. Në veçanti, shpenzimet për mbrojtjen sociale u rritën mesatarisht me 10% në vit në terma realë gjatë periudhës 2005 - 2017 (Tabela 10).

Tabela 10: Mbrojtja sociale si përqindje e PBB-së

Viti	Shpenzimet (% e PBB-së)	
	Çmimet aktuale	Çmimet konstante, 2005=100
2008	8.0%	7.2%
2009	8.2%	7.3%
2010	8.2%	7.3%
2011	8.3%	7.4%
2012	8.6%	7.8%
2013	9.2%	8.4%
2014	9.2%	8.4%
2015	9.1%	8.3%
2016	9.4%	8.4%
2017	9.3%	8.1%

Burimi: Të dhënat e FMN-së

Tabela 11 jep shpenzimet e qeverisë për mbrojtjen sociale krahasuar me sektorë të tjerë, përfshirë edhe prirjen për tre vitet e fundit.

Tabela 11: Shpenzimet e qeverisë qendrore sipas funksionit

% e PBB-së	Viti	Viti	Viti
	2019	2020	2021
1. Shërbime të përgjithshme publike	5.0	2.5	2.1
2. Mbrojtje	0.8	1.0	0.9
3. Rendi dhe siguria publike	1.8	2.0	1.9
4. Çështje ekonomike	3.0	2.6	2.9
5. Mbrojtja mjedisore	0.2	0.1	0.1
6. Strehimi dhe lehtësirat në komunitet	2.2	1.8	2.0
7. Shëndetësi	3.0	3.4	3.4
8. Zbavitje, kulturë dhe besim fetar	0.4	0.2	0.3
9. Arsim	3.3	2.9	2.7
10. Mbrojtja sociale	9.5	10.4	10.3

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Sa i përket burimeve të financimit të mbrojtjes sociale, më shumë se gjysma e mbrojtjes sociale në Shqipëri financohet përmes kontributeve shoqërore. Kontributi i përgjithshëm i qeverisë arrin në 49% të shpenzimeve totale, ose 32% të financimit për Fondin e Sigurimeve Shoqërore, që mbulon kontributet e paguara nga qeveria për kategori të veçanta, programet e posaçme të qeverisë, dhe financimin e deficitit të skemës publike të sigurimeve shoqërore. Tabela I2 paraqet prirjet e mekanizmave të shpenzimit për mbrojtjen sociale në Shqipëri.

Tabela 12: Mekanizmat e shpenzimeve për mbrojtjen sociale

	2015	2016	2017
Pagesat e sigurimeve shoqërore	81.8%	82.1%	82.7%
Kontribute të posaçme	45.9%	47.7%	51.1%
Kontributi i përgjithshëm i qeverisë	55%	53%	49%
Nga të cilat: Transferat të qeverisë për Fondin e Sigurimeve Shoqërore	36%	34%	32%

Burimi: FMN

Sipas të dhënave të qeverisë, shpenzimet për mbrojtjen sociale në Shqipëri përbëjnë 9,3% të PBB-së, një vlerë kjo konsiderueshëm më e ulët se mesatarja e BE-së prej 28%. Për shembull, në vitin 2016 Shqipëria shpenzoi 9,4% të PBB-së së vet për mbrojtjen sociale. Duhet theksuar se shpenzimet për mbrojtjen sociale në Shqipëri mbizotërohen nga shpenzimet për sigurimet shoqërore, që mesatarisht zënë më shumë se 75% të shpenzimeve të përgjithshme në të gjitha vitet e marra në konsideratë. Dy programet e tjera kryesore të mbrojtjes sociale janë ndihma ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar, të cilat mesatarisht përbëjnë 13% të shpenzimeve të përgjithshme publike sociale gjatë të njëjtës periudhë. Pjesa e mbetur e shpenzimeve në fushën e politikave sociale i kushtohet programeve të punësimit, aktualisht të administruara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (rreth 1% e buxhetit të përgjithshëm) si dhe shërbimeve të kujdesit shëndetësor, emergjencave dhe menaxhimit të strategjisë së mbrojtjes sociale. Tabela I3 paraqet shpenzimet e mbrojtjes sociale në nivel kombëtar në Shqipëri.

Tabela 13: Shpenzimet për Mbrojtjes Sociale në Shqipëri 2015-2021

Programi Buxhetor milion Lek	Viti				
	2015	2016	2017	2018	2019
Shërbimet e kujdesit shoqëror (shpenzimet e pakushtëzuara vendore)	493	528	684	842	1 135
Programi Buxhetor i Mbrojtjes Sociale	21 442	21 283	21 614	21 445	23 542
Programet e ndihmës ekonomike	17 662	20 026	20 714	20 671	21 100
Bonusi i bebes					1 870
Shërbimet të kujdesit shoqëror dhe kosto të tjera menaxhimi në MS	3 780	1 257	900	988	988
Përfshirja sociale	93	68	88	13	
Shërbimet e Punësimit	1 623	1 807	1 486	1 228	1 535
Nga të cilat: përfitime papunësie (pasive)	615	691	346	336	540
Emergjencat	1 419	1 266	1 109	1 542	1 503
Nëntotali i shpenzimeve në sektorin social (jo kontribute)	24 977	24 884	24 893	25 057	27 715
Fondi i Sigurimeve Shoqërore (pensionet)	107 309	114 276	119 081	125 364	130 927
Shpenzimet gjithsej për mbrojtjen sociale	132 286	139 160	143 974	150 421	158 642
Buxheti Total i Qeverisë	433 697	440 241	461 410	476 147	519 577
Mbrojtja sociale (pa sigurimet shoqërore)					
(si % e PBB-së)	1.7%	1.70%	1.60%	1.50%	1.50%
Si % e Buxhetit të Qeverisë	5.8%	5.70%	5.40%	5.30%	5.10%
Programet e mbrojtjes sociale në para					
Si % e Buxhetit të Qeverisë	4.1%	7.7%	7.7%	7.6%	7.5%
Si % e shpenzimeve sociale (jo kontribute)	70.7%	80.5%	83.2%	82.5%	82.9%
Si % e programit buxhetor të kujdesit shoqëror (qendror)	82.4%	94.1%	95.8%	96.4%	97.6%

Burimi: Të dhënat e Ministrisë së Financave

Shpenzimet e shërbimeve shoqërore për fëmijët

Shërbimet e kujdesit shoqëror përbëjnë një pjesë shumë të vogël (më pak se 5%) të shpenzimeve të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) për mbrojtjen sociale, ndërkohë që shpenzimet kryesore vjetore lidhen me skemën e ndihmës ekonomike dhe pagesën e aftësisë së kufizuar. Megjithatë shpenzimet për kujdesin shoqëror janë rritur pothuajse dyfish në terma nominalë, nuk ka pasur rritje të shpenzimeve për kujdesin shoqëror si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme, dhe faktikisht këto të fundit janë paksa më të ulëta tani se sa përpara dhjetë vjetësh.

Shpenzimet për shërbimet e kujdesit shoqëror në Shqipëri janë thuajse të papërfillshme dhe përbëjnë rreth 3% të programit të përgjithshëm buxhetor për mbrojtjen sociale (përfshirë fëmijët). E detyruar nga kufizimet fiskale, qeveria ka shkurtuar shpenzimet për mbështesin mirëqenien e fëmijëve. Analiza e buxhetimit për fëmijët sugjeron se: agjenda ekonomike kombëtare nuk pasqyron domosdoshmërisht përqendrimin tek fëmijët dhe familjet (përveç transfertave në para në kuadër të skemës së ndihmës ekonomike); në politikat dhe mjedisin fiskal ka vëmendje të kufizuar për shpenzimet për dhe arritjet e fëmijëve; ka njohuri të kufizuara për buxhetet miqësore me fëmijët dhe kapacitete të dobëta për matjen e efektshmërisë dhe efikasitetit të shpenzimeve publike për fëmijët; mungon lidhja ndërmjet politikave dhe prioritetëve të shpenzimit për fëmijët; mungon lidhja ndërmjet politikës dhe prioritetëve të shpenzimit për arritjen deri tek fëmijët më të cenueshëm; mungon një program për përfitimet e fëmijëve dhe familjeve dhe sistemi i kujdesit shoqëror për mbrojtjen e fëmijëve është i dobët.

Rritja e investimeve për fëmijët kërkon një vizion që siguron mbrojtjen sociale të fëmijëve bazuar në të drejtat e tyre, pavarësisht përballueshmërisë së shërbimit, si sigurimin e burimeve të përshtatshme që mbështesin akses të barabartë në kujdes apo arsim cilësor, pavarësisht gjendjes ekonomike, vendbanimit, etnisë, etj. Përparësitë duhet të lidhen me përcaktimet dhe burimet e përshtatshme buxhetore.

4.4 Hapësira Fiskale për Mbrojtjen Sociale

Hapësira fiskale mund të krijohet dhe ruhet në mënyra të ndryshme. Kjo pjesë bazohet ndjeshëm në kuadrin përcaktues të krijuar në Handley (2009), dhe ekzaminon mënyrat e mëposhtme për krijimin e hapësirës fiskale: rritjen e të ardhurave të brendshme si dhe prurjeve të ndihmës ndërkombëtare; reduktimin/anulimin e borxhit ose rritjen e huamarrjes; ricaktimin e shpenzimeve në sektorë; dhe rritjen e efektshmërisë së dhe reduktimin e harxhimeve të shpenzimeve publike.

Në këtë kontekst duhet të mobilizohen më shumë burime nëse Qeveria e Shqipërisë dëshiron të shtrijë mbulimin dhe të trajtojë shkallën e lartë të varfërisë dhe cenueshmërisë në vend, veçanërisht punën e papaguar dhe sektorin informal. Bazuar në të dhënat dhe informacionin e disponueshëm, mundësia më e madhe për hapësirë fiskale për mbrojtjen sociale krijohet përmes i) mobilizimit të burimeve vendase, ii) përmirësimit të menaxhimit të financave publike lidhur me shpenzimet publike (buxhetimi me ndjeshmëri gjinore dhe ndaj fëmijëve) dhe iii) përfitimit nga interesi i shtuar i donatorëve në mbrojtjen sociale. Megjithatë, garancia që kjo hapësirë fiskale do të përdoret për shtrirjen e programeve të mbrojtjes sociale, do të varet nga përkushtimi i qeverisë për mbrojtjen sociale.

Duke duhet marrë në konsideratë se shpenzimet aktuale për mbrojtjen sociale prej rreth 1,2% të PBB-së, çka është më pak se vendet e tjera evropiane. Sipas ILO-s 'kosto e një pakete të plotë përfitimesh në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme arrin deri në 4,2% të PBB-së' (Ortiz et al., 2017b: xi). Bazuar në bazën tatimore aktuale dhe nivelin e informalitetit në Shqipëri, si dhe duke marrë në konsideratë burimet e nevojshme për financimin e programeve të mbrojtjes sociale për kujdesin e papaguar, disa nga çështjet e mundshme të politikave përfshijnë krijimin e sistemeve të qëndrueshme të hapësirës fiskale, përfshirë sistemet e shpenzimeve publike me ndjeshmëri gjinore, si dhe përdorimin e rolit të rëndësishëm të kontributeve shoqërore si burim financimi, për të plotësuar tatimet e përgjithshme.

5. Përfundime

Barazia gjinore, përfshirë mirëqenien e fëmijëve, është një nga sfidat kyçe me të cilat përballen sistemet e mbrojtjes sociale në Shqipëri. Në kontekstin e tregjeve informale dhe gjinore të punës në Shqipëri, sistemet e mbrojtjes sociale përballen me pengesa në garantimin e përfitimeve sociale universale dhe të përshtatshme për gratë dhe fëmijët. Puna e papaguar e kujdesit, e cila trajtohet më pak nga sa është e përshtatshme, është thelbësore për zgjidhjen e sfidave të shumëfishta me të cilat përballen qeveria, dhe ka shumë pika të ndryshme hyrëse që mund të përdoren për të investuar për aksesin në kujdes cilësor, të përballeshëm dhe universal për fëmijën. Ndërkohë që financimet e reja janë padyshim të nevojshme për zgjerimin e aksesit në kuadër të përmasave të nevojshme, ka edhe një sërë mundësish për të përdorur financimin në kuadër të hapësirës fiskale ekzistuese që mund të financojnë zgjerimin e mbrojtjes sociale me ndjeshmëri gjinore dhe kujdesin universal për fëmijën. Identifikimi i hapësirës fiskale për investime kritike ekonomike dhe sociale është e nevojshme për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të fëmijëve dhe grave. Duke qenë e puna e papaguar është e rrënjësor dhe është thelluar më tej gjatë pandemisë, ka nevojë reale të investohet dhe të promovohet barazia gjinore për të ruajtur të drejtat e grave dhe vajzave. Në këtë kuadër, mbrojtja sociale me ndjeshmëri gjinore mund të trajtojë këto pabarazi, përfshirë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve duke: a) njohur, pakësuar dhe rishpërndarë punën e kujdesit që kryejnë gratë, b) shtuar shërbimet me përgjigjshmëri gjinore me qëllim reduktimin e barrës së kujdesit dhe shtimin e mundësive të punësimit dhe c) shtuar kontributin e burrave për kujdesin e papaguar dhe punët shtëpiake.

Rasti për investimin në mbrojtje sociale me ndjeshmëri gjinore dhe kujdes universal për fëmijën në Shqipëri

Të dhënat sugjerojnë se pandemia ka pasur një ndikim të konsiderueshëm mbi gratë në Shqipëri. Në Shqipëri, gratë jo vetëm humbën vendet e punës dhe mundësitë, por ato gjithashtu punuan më pak se sa zakonisht. Në këtë kontekst, kujdesi për fëmijën është për shumë individë një urë drejt vendeve të punës dhe mundësisë për të marrë pjesë në fuqinë e paguar të punës. Gjithashtu, ka edhe presion të jashtëzakonshëm mbi qeverinë për të rregulluar këtë urë, në mënyrë që veçanërisht gratë të kenë mundësi të rikthehen në fuqinë punëtore.

Për më tepër, aksesin në kujdes cilësor për fëmijët mund të ketë ndikime që shtrihen në shumë breza, duke përmirësuar punësimin dhe produktivitetin e grave, rezultatet e fëmijëve, mirëqenien e familjes dhe ekonominë në përgjithësi. Të dhënat shumëdimensionale, të paraqitura më lart, sugjerojnë se puna në kujdesin e papaguar ka efekte negative sa i përket hapjes së shtigjeve për dalje nga varfëria, zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe përmirësimit të barazisë, që janë të gjitha themele të rritjes ekonomike dhe produktivitetit.

Kutia 3: Investimi për trajtimin e punës së papaguar në Shqipëri

- Diagnostikimi dhe njohja e punës së papaguar
- Pakësimi i punës së papaguar
- Zhvendosja e punës së kujdesit: sistem kujdesi me ndjeshmëri gjinore
- Kompensim për punën e kujdesit, akses në punë dinjitoze, përfshirë pagën e barabartë dhe mbrojtjen sociale.

Burimi: Analizë e autorit

Analiza e të dhënave në këtë raport sugjeron se:

- Puna në kujdesin e papaguar ndikon gratë e punësuar në të gjitha nivelet e të ardhurave dhe arsimit, lidhur me mundësitë e tyre të punësimit dhe ekonomike.
- Puna në kujdesin e papaguar mund të kufizojë produktivitetin dhe llojin e punësimit në të cilin mund të angazhohen gratë, duke mos i lejuar ato të shfrytëzojnë mundësi më të shpërblyese dhe më fitimprurëse.
- Ka prova bindëse të ndikimit pozitiv të disponueshmërisë së kujdesit për fëmijën, mbi punësimin e grave gjatë arsimit, kujdesit për fëmijë dhe punësimit. Humbjet ekonomike që vijnë nga humbja e mundësive ekonomike nga gratë arrin në shifra që shkojnë përtej një miliard Dollarë në vit. Kjo do të thotë se **puna e grave ka rëndësi për ekonominë, shoqërinë dhe familjen.**
- Në Shqipëri ka një lidhje të fortë ndërmjet pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore dhe kujdesit për fëmijët. Kjo kërkon ekzaminimin e mënyrës se si puna e papaguar ndikon të ardhurat, sjelljen e shpenzimeve, dhe

zgjedhjet për investime të grave dhe fëmijëve në shoqëri, dhe të mënyrës se si politikat fiskale të shoqërisë ndihmojnë ato që ofrojnë punë shtëpiake të papaguar.

Në këtë kontekst, investimi në shërbimet e kujdesit universal për fëmijët do të trajtonin sa më poshtë:

- Puna e kujdesit është burim i konsiderueshëm punësimi në Shqipëri, veçanërisht për gratë. Kjo do të shtojë mundësitë e punësimit të grave (vende pune formale në kujdes, si profesionet e mbizotëruara nga femrat në kujdesin shëndetësor) dhe do të rrisë produktivitetin si në sektorin formal, ashtu edhe atë informal, dhe do të reduktojë pabarazinë gjinore në punësim dhe përmirësojë veprimtarinë në tregun e punës dhe të ardhurat;
- Do të promovohet kapital më i zhvilluar njerëzor përmes regjistrimit më të madh të fëmijëve në të nxënin dhe zhvillimin në fëmijërinë e hershme;
- Do të sigurohet akses i barabartë për të gjithë fëmijët në kujdes formal për fëmijët me qëllim mëkimin e shanseve të jetës dhe mirëqenien e fëmijëve, përfshirë sigurinë; dhe
- Investimet në ekonominë e kujdesit do të rezultojnë në hapjen e vendeve të drejtpërdrejta të punës. Ndërkohë, hapja e vendeve të drejtpërdrejta shtesë të punës në sektorët e kujdesit do të çojë në hapjen e vendeve jo të drejtpërdrejta.

Financimi i mbrojtjes sociale me ndjeshmëri gjinore dhe ndaj fëmijëve

Ka nevojë të kombinohen skemat e kontributeve dhe skemat e financuara nga tatimet për mbrojtjen sociale me përgjigjshmëri gjinore për gratë dhe vajzat, përfshirë shërbimet e kujdesit për fëmijën dhe kujdesit shoqëror, që kanë mbulim të qëndrueshëm e universal dhe që sigurojnë një bazë të mbrojtjes sociale për të gjithë. Në këtë kuadër, ka nevojë për një orientim të ri sa i përket hapësirës fiskale dhe shpenzimeve publike, si:

- Instrumente të financimit të mbrojtjes sociale që trajtojnë barazinë gjinore/të grave (punën e papaguar të kujdesit dhe informalitetin) përfshirë kujdesin për fëmijën.
- Mekanizmat e financimit të MS-së: Dhënia e prioritetit të ri shpenzimeve dhe tatimeve për zgjerimin e mbrojtjes sociale.
- Trajtimi i financimit të mbrojtjes sociale me përgjigjshmëri gjinore me elemente si sistemet e transferimit të tatimeve.
- Reforma politikash për të trajtuar çështje si ligjet për mbulimin me mbrojtje sociale për grupet e veçanta, p.sh. kujdesin e papaguar, punëtorët shtëpiakë dhe/ose për trajtimin e informalitetit dhe paqartësive në marrëdhëniet e punësimit.
- Mundësitë ligjore për përmirësimin e punësimit, përfshirë zgjerimin e përkufizimeve për të njohur punën që nuk mbulohet nga kontrata e punës.

Mobilizimi i burimeve për mbrojtjen sociale me ndjeshmëri gjinore dhe për fëmijën, duke përdorur hapësirën fiskale dhe përmirësuar provat

Analiza ka nxjerrë në pah nevojën për strategji kombëtare për kujdesin (nga ofrimi universal të shërbimeve cilësore të kujdesit tek politikat e tregut të punës, si integrimi i ofruesve të papaguar të kujdesit në fuqinë punëtore) me qëllim reduktimin e barrës së punës së papaguar që kryejnë gratë dhe hartimin e politikave fiskale që mbështesin ekuilibrin ndërmjet punës dhe jetës personale.

- Duhet të ndërmerren veprime për rritjen e investimeve në mbrojtjen sociale me përgjigjshmëri gjinore duke përdorur si instrument hapësirën fiskale (mjedisin makroekonomik me politika të përshtatshme fiskale dhe monetare, përfshirë shpenzimet publike me ndjeshmëri gjinore për financimin e kujdesit, dhe politikat e tregut të punës, duke përfunduar për shembull administrimin e të ardhurave me qëllim përsheptimin e mbrojtjes së grave dhe fëmijëve.
- Duhet të merren hapa për hartimin, zbatimin dhe ndjekjen e politikave fiskale dhe buxhetimit me ndjeshmëri gjinore dhe për fëmijën, me qëllim promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave, duke optimizuar ndër të tjera, shpenzimet fiskale për shtrirjen e mbulimit me mbrojtje sociale.
- Duhet të forcohen kapacitetet e palëve të interesit, si Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe institucioneve të tjera përkatëse të qeverisë, për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave të kategorizuara sipas seksit, të ardhurave, moshës, aftësisë së kufizuar dhe tipareve të tjera me rëndësi për kontekstin kombëtar, me qëllim mbështetjen e politikave dhe veprimeve fiskale për përmirësimin e aksesit të grave dhe vajzave në mbrojtje sociale.

Lista e Tabelave

Tabela 1: Treguesit e varfërisë nga Anketa e Kushteve të Jetesës 2017-2018

Tabela 2: Shkalla e rrezikut për të qenë i varfër sipas gjinisë.

Tabela 3: Varfëria dhe përjashtimi social

Tabela 4: Pjesëmarrja në fuqinë punëtore

Tabela 5: Shkalla e punësimit

Tabela 6: Papunësia

Tabela 7: Përbërja e punësimit informal sipas seksit (%)

Tabela 8: Produktet e buxhetimi të përgjigjshëm gjinor (2015 - 2017)

Tabela 9: Treguesit e hapësirës fiskale për Shqipërinë

Tabela 10: Mbrojtja sociale si përqindje e PBB-së

Tabela 11: Shpenzimet e qeverisë qendrore sipas funksionit

Tabela 12: Mekanizmat e shpenzimeve për mbrojtjen sociale

Tabela 13: Shpenzimet për Mbrojtjes Sociale në Shqipëri 2015-2021

Lista e Figurave

Figura 1: Shkalla e punësimit, 15-64 vjeç

Figura 2: Koha e kaluar me punë të papaguar kujdesi sipas numrit dhe moshës së fëmijëve në familje (gratë)

Figura 3: Koha e kaluar në punë të papaguar kujdesi sipas nivelit arsimor (gratë)

Figura 4: Numri mesatar i orëve të kaluara në punë shtëpie sipas gjinisë

Figura 5: Kujdesi për fëmijën sipas gjinisë

Figura 6: Disponueshmëria e burimeve nga tatimet dhe ODA-të (2003-2018)

Figura 7: Të ardhura tatimore gjithsej (2010-2019)

Kutitë

Kutia 1: Puna e papaguar e kujdesit

Kutia 2: Vlera e punës së papaguar të grave në Shqipëri

Kutia 3: Investimi për trajtimin e punës së papaguar në Shqipëri

Referencat

1. Bahn, K., Cohen, J., & Meulen Rodgers, Y. (2020). Një pikëpamje feministe mbi COVID-19 dhe vlerën e punës së kujdesit në botë. *Gender, Work & Organization*, 27(5), 695–699. <https://doi.org/10.1111/gwao.12459>
2. Braho A, dhe Ymeri S, 2018. Analizë e Buxhetit për Shpenzimet që Lidhen me OZHQ-të në Shqipëri: 2015–2017. UNRCO.
3. Charmes, J. (2019). Puna e papaguar e kujdesit dhe tregu i punës: Një analizë e të dhënave të përdorimit të kohës bazuar në përmbledhjen më të fundit botërore të anketave të përdorimit të kohës. Organizata Ndërkombëtare e Punës. <https://www.ilo.org/global/publications/lang--en/index.htm>
4. Cook, R., & Grimshaw, D. (2021). Një lente gjinore mbi punësimin dhe politikat sociale në Evropë gjatë COVID-19 *European Societies*, 23(supl), S215–S227. <https://doi.org/10.1080/14616696.2020.1822538>
5. Czymara, C. S., Langenkamp, A., & Cano, T. (2021). Shkak për shqetësim: Pabarazia gjinore gjatë përjetimit të mbylljes së COVID-19 në Gjermani. *European Societies*, 23(supl), S68–S81. <https://doi.org/10.1080/14616696.2020.1808692>
6. Dang, H. A. H., & Viet Nguyen, C. (2021). Pabarazia gjinore gjatë pandemisë së COVID-19: Të ardhurat, shpenzimet, kursimet dhe humbja e punësimit. *World Development*, 140, 105296. <https://doi.org/10.1016/j.worlddev.2020.105296>
7. Zyra Ndërkombëtare e Punës. (2018). Puna e kujdesit dhe vendet e punës në kujdes për të ardhmen e punësimit dinjitoz. Zyra Ndërkombëtare e Punës.
8. INSTAT, UNDP dhe UN Women, Anketa VAWG, 2019. Format e dhunës: dhuna nga partneri intim, dhuna gjatë shoqërimit, dhuna nga jo partneri, ngacmimi seksual, ose përndjekja.
9. INSTAT (2018). Anketa e Fuqisë Punëtore (LFS).
10. Ortiz, I., Durán-Valverde, F., Pal, K., Behrendt, C., & Acuña-Ulate, A. (2017b). Dyshemetë e mbrojtjes sociale universale: Vlerësimi i kostos dhe përballueshmërisë në 57 vende me të ardhura të ulëta (Dokument Pune 58 i ESS). Gjenevë: ILO.
11. Ortiz, I., Cummins, M., & Karunanethy, K. (2017a). Hapësira Fiskale për Mbrojtjen Sociale dhe OZHQ-të: Alternativat për zgjerimin e investimeve sociale për 187 vende (Dokumenti i Punës 48 i ESS). Gjenevë: Zyra Ndërkombëtare e Punës.
12. Sullivan, O. (2019). Pabarazia gjinore në ekuilibrin ndërmjet punës dhe jetës personale. *Nature Human Behaviour*, 3(3), 201–203. <https://doi.org/10.1038/s41562-019-0536-3>
13. Ndikimi i COVID-19 mbi jetën dhe jetesën e grave dhe burrave në Evropë dhe Azinë Qendrore: Gjetjet Paraprake të Vlerësimit të Shpejtë Gjinor, UN Women, 2020 <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/07/the-impact-of-covid19-on-womens-and-mens-lives-and-livelihoods>
14. Kombet e Bashkuara. (2020). Dokument politikash: Ndikimi i COVID-19 mbi gratë Kombet e Bashkuara. <https://www.un.org/development/desa/dpad/>
15. UNICEF, Analizë e Situatës së Fëmijëve (SITAN), 2019; Komisioni Evropian, DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT Raporti për Shqipërinë 2019, Bruksel, 29.5.2019, 93.
16. Xue, B., & McMunn, A. (2021). Dallimet gjinore në punën e papaguar të kujdesit dhe vështirësitë psikologjike gjatë mbylljes për Covid-19 në MB. *PLOS ONE*, 16(3), e0247959. <https://doi.org/10.1371/journal.pone.0247959>

